



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 204, Datë 01.09.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 142, DATË 07.07.2025,
“MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “ARIS ALBANIA” SH.P.K.”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 01.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2298/3 prot., datë 26.08.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 142, datë 07.07.2025, mbi kërkesën e shoqërisë “ARIS ALBANIA” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e shoqërisë “ARIS ALBANIA” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “ARIS ALBANIA” sh.p.k.

- Me vendimin nr. 55, datë 22.02.2021, bordi i ERE-s ka licencuar shoqërinë “ARIS ALBANIA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Guri i Zi” me kapacitet të instaluar 1719 kW, HEC “Daznjanë” me kapacitet të instaluar 1518 kW, dhe HEC “Shëlli” me kapacitet të instaluar 1518 kW, me kapacitet total të instaluar 4755 kW, për një afat 30 vjeçar.
- Në vijim, me vendimin nr. 142, datë 07.07.2025, bordi i ERE-s ka miratuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “ARIS ALBANIA” sh.p.k., duke përcaktuar se ortakut kryesor i shoqërisë me 55% të kuotave të kapitalit bëhet Z. S. C. Sipas këtij vendimi, shoqëria ka detyrimin të depozitohet në ERE ekstraktin historik të regjistrimit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi i ndryshimit të ortakut në QKB dhe ky vendim mbetet objekt rishikimi nëse kërkohet nga organet e tjera kompetente ose në rastet e përcaktuara nga ERE.

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE me shkresën nr. 1671/14 prot., datë 09.07.2025, njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 142/2025, si dhe i solli në vëmendje mbajtjen në konsideratë të plotësimit të kushteve të lëna në këtë vendim.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2298 prot., datë 07.08.2025 dhe nr. 2298/1 prot., datë 11.08.2025, në zbatim të pikës 4 të vendimit, ka depozituar në ERE ekstraktin historik të regjistrimit tregtar, të vulosur elektronikisht nga QKB më datë 08.08.2025, nga i cili rezulton se është kryer ndryshimi i ortakëve. Konkretisht, Z. A Ç është larguar nga shoqëria duke

transferuar 15% të kuotave të kapitalit në favor të Z. Sh C, i cili tashmë zotëron 55% të kuotave të shoqërisë, pra mazhorancën.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në përputhje me përcaktimet e vendimit të bordit të ERE-s nr. 142, datë 07.07.2025, rezulton se shoqëria “ARIS ALBANIA” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, pasi ka depozituar në ERE ekstraktin historik të përditësuar të regjistrit tregtar më datë 08.08.2025, nga i cili reflektohet ndryshimi i ortakëve.
- Përditësimi i ekstraktit historik të regjistrit tregtar është kryer më datë 30.07.2025 dhe është depozituar në ERE brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Bordit, duke respektuar plotësisht kërkesat e vendimmarrjes.
- Meqenëse kushti i parashikuar në pikën 4 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 142, datë 07.07.2025 është përmbushur, vlerësohet se kjo pikë duhet të shfuqizohet si e ekzekutuar.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet nga organi publik që ka kompetencën për ta nxjerrë, vlerësohet se pika 4 e vendimit të bordit të ERE nr. 142, datë 07.07.2025, duhet të shfuqizohet, pasi shoqëria “ARIS ALBANIA” sh.p.k. e ka përmbushur kushtin e përcaktuar në këtë pikë.
- Si rrjedhojë, lind nevoja për të ndryshuar edhe pikën 5 të vendimit nr. 142/2025, në mënyrë që ajo të bëjë referencë vetëm ndaj kushtit të mbetur në fuqi, përkatësisht pikës 3 duke siguruar koherencë dhe qartësi në përmbajtjen e dispozitivit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 4 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 142, datë 07.07.2025, shfuqizohet.
2. Pika 5 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 142, datë 07.07.2025, ndryshon dhe bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 3 të këtij vendimi.”
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “ARIS ALBANIA” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI